



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilimjen/Prodato Received/Delivery	19.08.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	4831/2022	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SEPMSHCK			1/3



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.614/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malësore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.614/2022 të datës 14.07.2022, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi

kundër organit të punësimit Komuna e Obiliqit, në çështjen juridike 'kontestim konkursi', duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 19.08.2022, mori këtë:

### V E N D I M

*Përfundon procedimi administrativ* lidhur me ankesën A.nr.614/2022 të datës 14.07.2022 të parashtruar nga ankuesja

### A r s y e t i m

Ankuesja kandidatë për shërbim civil, më datë 14.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4089/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit II-772 të datës 28.06.2022 të Kryetarit të Komunës së Obiliqit lidhur me anulimin e Konkursit më numër reference RN0007960 për pozitën "Zyrtar për Biblioteka 4".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 18.07.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit të Komuna e Obiliqit, ndërsa më datë 29.07.2022 Këshilli ka pranuar shkresat lidhur me çështjen ankimore në vendosje.

*Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:* Ankesën me numër të protokollit 4089/2022 të datës 14.07.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër II-772 të datës 28.06.2022 të Kryetarit të Komunës së Obiliqit, Vendimin e Këshillit A.nr.398/2022 të datës 02.06.2022; Formularin për kërkesë apo ankesë të datës 13.07.2022; Vlerësimin përfundimtar të datës 01.04.2022; Njoftimin me numër XII-





94 të datës 23.03.2022 për kandidatin e suksesshëm; Dokumentin e identifikimit të ankueses; Konkursin me Nr. Reference RN00007960 të datës 09.12.2021 për pozitën "Specialist i Shkencave Shoqërore-Zyrtar për Biblioteka 4", kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokollit 4180/2022 të datës 18.07.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 4397/2022 të datës 29.07.2022; Vendimin me numër protokollit II-109 të datës 23.02.2022 për themelimin e Komisionit të Pranimit; Lista e kandidateve/aplikues; Njoftimin me numër protokollit XII-05 i datës 21.01.2022; e-malin e datës 14.03.2022 të drejtuar kandidateve lidhur me njoftimin e testit me shkrim; Listën e aplikanteve për grup Specialist i Shkencave Shoqërore-Zyrtar për Biblioteka 4" të datës 07.03.2022; Renditja përfundimtare e kandidateve e datës 23.03.2022; e-malin e datës 14.03.2022 të drejtuar kandidateve lidhur me intervistën me gojë; e-malin e datës 23.03.2022 të drejtuar A.Morina drejtuar M.A; e-malin e datës 23.03.2022 të drejtuar Emalin e datës 28.04.2022 të drejtuar e-malin e datës 23.03.2022 të drejtuar e-malin e 22.03.2022 të drejtuar Aplikacioni i datës 04.01.2022 i ankueses; Dosjen e ankueses: Diplomën me numër të protokollit 06-84/22 të datës 03.06.2006; Diplomën me numër 63/13 të datës 05.07.2013; Diplomën lidhur me studimet pasdiplomike (numri dhe data nuk mund të identifikohet); Letrën motivuese; Certifikatën lidhur me trajnimin në "Kontabilitet dhe Tatimet Praktike" të mbajtur me datën 08.10.2016 deri me datën 15.12.2015; CV: e-malin e datës 16.08.2022 me numër të protokollit 4755/2022 të drejtuar Këshillat te Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 16.08.2022 përmes emailit zyrtar të drejtuar Ankueses; Kërkesën për pushim të Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit; Kërkesën e datës 13.07.2022 të ankueses drejtuar Burimeve njerëzore në Komunën e Obiliqit; e-maili i datës 16.08.2022 nga drejtuar Këshillit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedurës administrative të iniciuar sipas ankesës A.nr.614/2022 të datës 14.07.2022 , **SEPSE:**

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Komuna e Obiliqit më datë 09.12.2021 ka publikuar njoftimin për shpalljen e Konkursit me numër reference RN00007960 për grupin e pozitës "Specialist i Shkencave Shoqërore-Zyrtar për Biblioteka 4", një pozitë, në Sektorin e Kulturës në Komunën e Obiliqit, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja. Bazuar në Njoftimin me numër protokollit XII-94 të datës 23.03.2022, kandidatja është renditur si kandidatja me më shumë pikë gjithsej 74.6 pikë, ndërsa ankuesja si kandidatja e dytë më gjithsej 70.2 pikë. Kundër vlerësimit përfundimtar të Komisionet të Pranimit, kandidatja në cilësi të aplikuses ka parashtruar ankesë me numër A.nr.398/22 të datës 19.04.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, ndërsa Këshilli me Vendimin me numër A.nr.398/2022 të datës 02.06.2022 ka aprovuar ankesën e ankueses si të bazuar dhe ka anuluar Procedurën e Rekrutimit me numër Kodi RPC00017960 për grupin e pozitës "Specialist i Shkencave Shoqërore-Zyrtar për Biblioteka 4", me arsyetimin së kjo procedurë ka qenë e përfshirë më shkelje procedurale dhe materiale të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranim dhe Karrierë në Shërbimin Civil. Kryetari i Komunës së Obiliqit duke vepruar sipas vendimit të Këshillit, me vendimin me numër protokollit II-772 të datës 28.06.2022 ka anuluar vendimin më nr.II-94 të datës 23.03.2022 të Komisionit të pranimit si dhe konkursin me numër reference RN00007960 për grupin e pozitës "Specialist i Shkencave Shoqërore-Zyrtar për Biblioteka 4".



Ankuesja kundër Vendimit me numër protokolli II-772 të datës 28.06.2022 të Kryetarit të Komunës së Obiliqit, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil më pretendimet së bazuar në Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranim dhe Karrierë në Shërbimin Civil e njëjta është kandidatë fituese pasi që ka arritur 70.2 pikë. Me tej shton se me Vendimin e Këshillit A.nr.398/2022 të datës 19.04.2022, është vendosur sipas ankesës të drejtuar kundër kandidatës së parë, e jo kundër ankueses. Kërkon që Këshilli të shfuqizoj Vendimin me numër protokolli II-772 të datës 28.06.2022 të Kryetarit të Komunës së Obiliqit dhe Vendimin nr.XII-94 të datës 23.03.2022 si dhe të emëroj ankuesen si kandidatë fituese.

Bazuar në gjendjen faktike si me lartë, dhe duke marrë parasysh së objekti i kontestit sipas ankesës ka të bëjë me procedurën e rekrutimit për të cilën Këshilli me Vendimin A.nr.614/2022 të datës 14.07.2022 ka vendosur në mënyrë meritorë respektivisht e ka anuluar në tërësi si të paligjshme, Kolegji i Këshillit konstaton së objekti i ankesës A.nr.614/2020 të datës 14.07.2022 është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje, dhe si rrjedhojë Kolegji në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot, vendosi që të përfundoj procedimin administrativ i filluar sipas ankesës A.nr.614/2020 të datës 14.07.2022.*

Theksuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

#### **Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

### **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS** **Lënda A.nr.614/2022**

**Ilire Mehmeti-SHAQIRI**

*Procesmbajtëse*

**Ardita HAXHNIKAJ DEMI**

*Kryetare e Kolegjit*

#### **Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Obiliqit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

